



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 gusht 2024
Nr. ref.: RK 2505/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI37/23

Parashtrues

**Negjati Beqaj, Behlul Beqaj, Gazmend Beqaj, Ymrije Beqaj, Shemsije Bečaj Rexhaj,
Lule Beqaj, Drilon Beqaj dhe Herolind Beqaj**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit Rev. nr. 74/22 të 12 shtatorit 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Negjati Beqaj, Behlul Beqaj, Gazmend Beqaj, Ymrije Beqaj, Shemsije Beqaj Rexhaj, Lule Beqaj, Drilon Beqaj dhe Herolind Beqaj, nga Prizreni, të përfaqësuar nga Ekrem Agushi, avokat në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev. nr. 74/22] të 12 shtatorit 2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 3167/2018] e 11 gushtit 2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).
3. Përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 11 tetor 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrotjtja e Pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 11 shkurt 2023, parashtruesit e kërkesës përmes e-mailit e dorëzuan kërkesën e tyre në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata), e cila kërkesë u regjistrua më 13 shkurt 2023, pasi që 11 shkurti 2023 ishte ditë e shtunë.
8. Më 16 shkurt 2023, Kryetarja përmes Vendimit [nr. GJR. KI37/23] caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [nr. KSH. KI37/23] caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Remzie Istrefi-Peci (anëtarë).
9. Më 28 shkurt 2022, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e pretenduar të parashtruesve të kërkesës për regjistrimin e kërkesës, duke kërkuar nga i njëjti që të sqarojë se kush janë parashtruesit e kërkesës meqenëse emrat e personave të cekur në formularin e kërkesës nuk përputhen me emrat në vendimet e gjykatave të rregullta, dhe të dorëzojë autorizimin specifik për Gjykatë Kushtetuese që dëshmon se i njëjti i përfaqëson parashtruesit e lart cekur para Gjykatës.
10. Më 13 mars 2023, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dorëzoi autorizimin specifik në Gjykatën Kushtetuese, dhe sqaroi se kush janë parashtruesit e kërkesës, duke dërguar kopje të dokumentit të identitetit për secilin, dhe kopje të certifikatës së vdekjes së të ndjerit, Behlul Beqaj.
11. Më 21 mars 2023, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme dhe Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) për regjistrimin e kërkesës, duke kërkuar nga kjo e fundit që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, të bashkëngjitë fletëkthesën që dëshmon se kur e kanë pranuar parashtruesit Aktgjykimin [Rev. nr. 74/22] të 12 shtatorit 2022 të Gjykatës Supreme.
12. Më 24 mars 2023, Gjykata Themelore dorëzoi fletëkthesën e kërkuar, e cila dëshmon se parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar Aktgjykimin [Rev. nr. 74/22] e 12 shtatorit 2022 të Gjykatës Supreme më 11 tetor 2022.
13. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
14. Më 17 korrik 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

15. Nga shkresat e rastit, rezulton se më 25 prill 1961 ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe Shyqri Beqaj (babai i parashtruesve) ishte lidhur kontrata për ndërrimin e paluajtshmërisë, e cila ishte legalizuar në Gjykatën Komunale në Prizren [Leg. nr. 378/61], dhe mbi bazën e të cilës kontraktuesi i dytë ishte pajtuar që paluajtshmërinë në pronësi të tij, për nevoja të "Svillarski Put", në vendin e quajtur "Pashalladi", në sipërfaqe prej 0.2ha. me përkufizime dhe matje të përcaktuara në pikën 1. të kontratës, e regjistruar si parcelë në emër të kontraktuesit Shyqeri Beqaj, në fletën poseduese nr. 3654 parcela nr. 7104 ZK. Prizren, ta ndërroj me kontraktuesin e parë, ndërsa kontraktuesi i parë nëpërmjet përfaqësuesit të saj ishte pajtuar që në emër të këtij ndërrimi dhe si kompensim për këtë paluajtshmëri të ndërruar, t'ia jep kontraktuesit të dytë pasurinë e përgjithshme popullore në vendin e

quajtur "Ortakol", në sipërfaqe prej 0.22.55ha. me përkufizime dhe matje si në pikën II. të kontratës me nr. të parcelës 7144, dhe fletë poseduese nr. 3576.

16. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesit e kërkesës parashtruan padi kundër Komunës së Prizrenit, ku kërkuan anulimin e kontratës mbi ndërrimin e paluajtshmërisë, të cilën paraardhësi i tyre i ndjerë, e ka lidhur me Komunën e Prizrenit dhe e njëjta ishte legalizuar nga Gjykata Komunale në Prizren më 25 prill 1961. Përmes kësaj padie, pretenduan se paluajtshmëritë në fjalë u janë marrë nga e paditura me qëllim të arondimit dhe zgjerimit të kompleksit i cili do të jetë pasuri e përgjithshme shoqërore. Po ashtu, theksuan se kontrata është lidhur kundër vullnetit të paraardhësit të tyre, me kërcënimin e dëbimit nga puna dhe partia, pra nën kushtet e ekzistimit të presionit, kërcënimit dhe shantazhit, gjë që bëjnë kontratën absolutisht nule.
17. Në një datë të pasaktësuar, e paditura Komuna e Prizrenit parashtrroi përgjigje në padi, me të cilën e kontestoi në tërësi atë, duke theksuar se ajo nuk ka legjitimitet pasiv në këtë kontest. E paditura konsideroi se nuk ka kurrfarë obligimesh ndaj parashtruesve të kërkesës, për shkak se me anulimin e kontratës së shitblerjes së paluajtshmërisë [Leg. nr./2045/63], e lidhur ndërmjet Shyqri Beqajt (paraardhësit të parashtruesve të kërkesës) dhe KBI Progresit, e anuluar sipas Aktgjykimit të plotfuqishëm [C. nr. 595/97] nuk është krijuar efekti ndaj personave të tretë, andaj sipas argumentimit të Komunës si palë e paditur: *"Paditësit për shkak të pamundësisë të kthimit të parcelës së tyre të bartur në KBI Progres e kanë të drejtën të kërkojnë nga ky subjekt kompensimin. Kjo është paraparë me nen.104 Ligji mbi marrëdhëniet detyrimore. Pavarësisht nga ajo se këtë parcelë në këtë procedurë me nacionalizim e ka marrë Komuna nga KBI Progresi, kjo nuk e obligon Komunën ndaj paditësve"*.
18. Më 27 nëntor 2017, nëpërmjet Aktgjykimit [C. nr. 888/17], Gjykata Themelore aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, duke:
 - (i) vërtetuar se është nule kontrata për ndërrimin e paluajtshmërisë Zyr. Leg. nr. 378/61, e legalizuar në Gjykatën Komunale në Prizren më 25 prill 1961, me të cilën është bërë ndërrimi i paluajtshmërisë par. kat. nr. 7104, arë e klasit të II në vendin e quajtur "Pashalladi", në sipërfaqe prej 0.39, 95h, e cila udhëhiqet sipas listës poseduese nr. 365ZP Prizren, par. kat. nr.7144 me kulturë kopsht e klasit të II, në sipërfaqe prej 0.22,95h, e cila udhëhiqet sipas listës poseduese 3576ZK Prizren, të cilën e paditura Komuna e Prizrenit është e obliguar ta pranojë, të gjitha në afat prej 15 ditëve, me plotfuqishmërinë e aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit.
 - (ii) obliguar e paditura Komuna e Prizrenit, që parashtruesve ligjorë si trashëgimtarë të të ndjerit Shyqri Beqaj t'ua dorëzojë në posedim dhe disponim të lirë pjesën e par. kat. nr. 7104 në sipërfaqe prej 18.52 ari.
 - (iii) vërtetuar se padia është e tërhequr në pjesën me të cilën kërkohet dorëzimi në posedim të pjesës së par. kat. nr. 7104 në sipërfaqe prej 13,33h, e cila është e ekspropriuar për shkak të ndërtimit të shinave të hekurudhës Prizren, Fushë-Kosovë dhe pjesa e paluajtshmërisë së theksuar në sipërfaqe prej 0,02,23 h, në të cilën është ndërtuar rruga e asfaltuar për zonën industriale, sepse për këtë pjesë të sipërfaqes do të iniciohet procedurë e posaçme.
19. Në arsyetim të këtij Aktgjykimi, Gjykata Themelore theksoi se, pas dëgjimit të dëshmitarëve, të njëjtit janë të një fjale se ka pasur presion ndaj të ndjerit gjatë lidhjes së kontratës lëndore, rrjedhimisht Gjykata Themelore vlerësoi se kontrata lëndore është lidhur nën kushtet e ekzistimit të dhunës dhe presionit, dhe rrjedhimisht është absolutisht

nule në kuptim të nenit 103 dhe 110 të Ligjit nr. 29/78 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejme: LMD). Po ashtu, shtoi se rrethanat në të cilat është lidhur kontrata udhëzojnë edhe në shkeljen e të drejtës ndërkombëtare, e cila sipas nenit 22 të Kushtetutës, do të zbatohet drejtpërdrejtë dhe ka epërsi në rast të konfliktit mbi të gjitha dispozitat ligjore dhe aktet e tjera të institucioneve publike, duke theksuar se me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, rregullohet e drejta në pronësi.

20. Gjykata Themelore përfundoi se *“...me anulimin e kontratës së shitblerjes së paluajtshmërisë krijohet edhe supozimi juridik që paditësit me padinë e revindikacionit të kërkojnë kthimin e parcelës kadastrale të theksuar e cila në posedim të të paditurit, sepse krijohen pasoja juridike të nulitetit të kësaj kontrate që nga lidhja e saj (ex tunc), që do të thotë se pasojat janë të atilla që kontratë nuk ka dhe për këtë arsye e paditura nuk ka bazë juridike për mbajtjen në posedim të paluajtshmërive kontestuese. Sipas dispozitave të nenit 37 Ligji mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike (Gaz.zyr.R.S.F.J nr.6/80 deri 36/90 në tekstin e mëtejme: LMTHFJ), i cili ligj është aplikuar në kohën e parashtrimit të padisë, pronari me padi mund të kërkojë nga mbajtësi kthimin e sendit individualisht të caktuar pra paluajtshmërisë me atë që duhet të argumentoj se në sendin kthimin e të cilit e kërkon e ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet në pushtetin faktik të të paditurit dhe kjo e drejtë e pronarit nuk parashkruhet. Paditësit tani si pronarë të paluajtshmërisë lëndore kanë të drejtë që në kuptim të dispozitave të nenit 3 LMTHFJ-së këtë paluajtshmëri ta mbajnë në posedim, ta shfrytëzojnë dhe të disponojnë me atë në kufijtë e caktuar me ligj. Pronari duhet të argumentoj se në sendin kthimin e të cilit e kërkon e ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet në pushtetin faktik të të paditurit. Nga kjo dispozitë del se pronari i sendit me kërkesë mund ta kërkojë dorëzimin e sendit në posedim nga pronari i cili atë send - paluajtshmëri e mban në posedimin faktik do të thotë gjendet në pushtetin faktik në kohën e parashtrimit të padisë së revindikacionit”.*
21. Më 28 maj 2018, e paditura, Komuna e Prizrenit, parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [C. nr. 888/17] të 27 nëntorit 2017, për shkak të (i) shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, (ii) konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe (iii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të prishë aktgjykimin e goditur me ankesë dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.
22. Në një datë të pasaktësuar, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës, paraqiti përgjigje ndaj ankesës së të paditurës, përmes të cilës i kontestuan pretendimet ankimore të të paditurës, me propozim Gjykatës së Apelit që aktgjykimi i goditur me ankesë të vërtetohet.
23. Më 11 gusht 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 3167/18], aprovoi si të themeltë ankesën e të paditurës Komuna e Prizrenit, ndryshoi piken I nënpikat (a) dhe (c) dhe piken II të Aktgjykimit [C. nr. 888/17] e 27 nëntorit 2017 të Gjykatës Themelore dhe e gjykoi çështjen kontestuese, duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, ndërsa pika I nënpika (c) e aktgjykimit të Gjykatës Themelore mbeti e pa shqyrtuar.
24. Në arsyetim të këtij Aktgjykimi, Gjykata e Apelit theksoi se gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore. Për pasojë, me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstatoi një gjendje faktike tjetër nga ajo që ishte konstatuar nga Gjykata Themelore. Rrjedhimisht,

Gjykata e Apelit përfundoi se kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës është tërësisht e pabazuar.

25. Gjykata e Apelit shtoi se nuk ka gjetur asnjë fakt sipas të cilit kontrata lëndore do të kualifikohej si e tillë që të përmbushte rrethanat që e bëjnë të njëjtën absolutisht nule, ndërsa nëse kërkesa e padisë referohet vetëm në të metat e vullnetit të kontratës, atëherë çështja do të duhej të trajtohej në kuadër të dispozitave ligjore për kontratat e rrëzueshme, të cilat sipas nenit 117 të LMD-së iu nënshtrohen afateve ligjore prekluzive. Gjykata e Apelit përfundoi se padia e parashtruesve të kërkesës është parashtruar pas kalimit të afatit ligjor.
26. Gjykata e Apelit e refuzoi edhe pjesën e kërkesëpadisë së paditësve me të cilën kanë kërkuar dorëzimin e paluajtshmërisë në posedim, duke theksuar se parashtruesit e kërkesës, si jo pronarë të pjesës së kësaj ngastre nuk mund të kërkojnë dorëzimin e paluajtshmërisë nga pronari i saj, në këtë rast Komuna e Prizrenit: *“Vetëm pronari i paluajtshmërisë ka autorizim të kërkojë prej poseduesit jo pronar i cili mban atë paluajtshmëri në posedim kthimin e saj. Në rastin konkret e paditura është pronare e ngastrës kontestuese edhe e pjesës së lartcekur, dhe ajo nuk mund të detyrohet t’ia kthejë këtë pjesë të paluajtshmërisë paditësve, pasi që baza e tyre e anulimit të kontratës mbi ndërrimin ra përkatësisht u refuzua, pra mbeti në fuqi kontrata mbi ndërrimin e paluajtshmërisë si bazë e fitimit të së drejtës së pronësisë prej të paditurës”.*
27. Më 9 tetor 2021, parashtruesit e kërkesës paraqitën revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të (i) shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshojë të njëjtin, në mënyrë që të vërtetojë aktgjykimin e shkallës së parë dhe ta detyrojë të paditurën t’ia kompensojë parashtruesve të kërkesës shpenzimet e procedurës kontestimore, ose të anulojë aktgjykimin e kontestuar dhe çështjen t’ia kthejë në rigjykim gjykatës së shkallës së dytë.
28. Lidhur me shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore, parashtruesit e kërkesës theksuan se gjatë procedurës së zhvilluar, gjykata e shkallës së dytë ka bërë shkelje qenësore të dispozitave të nenit 214, lidhur me nenin 182 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), me arsyetimin se e njëjta paraqiti arsye kundërthënëse me përmbajtjen e vërtetë të dokumenteve-provave materiale, të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Parashtruesit e kërkesës theksuan se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar faktin se paraardhësi i paditësve kontratën kontestuese për ndërrimin e paluajtshmërisë e ka lidhur nën ndikimin e kërcënimit me aplikimin e masave represive ndaj pasardhësit të paditësve, duke ushtruar dhunë fizike, torturë dhe kërcënim se familja e tij do të bojkotohet si dhe do të aplikohen masa tjera të dhunshme.
29. Lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, parashtruesit e kërkesës theksuan: *“në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me shkaqe për nulitetin relativ të kontratës sikundër gabimisht vlerëson gjykata e shkallës së dytë, por kemi të bëjmë me shkaqe për nulitetin absolut të kontratës kontestuese e cila nuk mund të krijojë efekt juridik ndërmjet palëve kontraktuese dhe për këtë arsye e në pajtim me dispozitat e nenit 104 të LMD-së i cili ka qenë ligj i zbatueshëm në Kosovë sipas rregullores së UNMIK-ut e tërë paluajtshmëria e cila mbi bazën e kësaj kontrate të pavlefshme ka kaluar në pronësi të paditurës duhet të lirohet nga sendet dhe njerëzit dhe e paditura të detyrohet që këtë paluajtshmëri kontestuese t’ia dorëzojë paditësve në posedim të qetë dhe faktik si dhe e njëjta të regjistrohët në regjistra të paluajtshmërive në pronësi të paditësve”.*

30. Më 6 janar 2022, e paditura, Komuna e Prizrenit, parashtroi përgjigje në revizion, me propozimin që Gjykata Supreme ta refuzonte si të pathemeltë revizionin e paraqitur nga parashtruesit e kërkesës dhe të vërtetonte Aktgjykimin [Ac. nr. 3167/2018] të 11 gushtit 2021, duke theksuar se parashtruesit e kërkesës në revizion nuk kanë paraqitur asnjë provë dhe asnjë bazë ligjore me të cilën do ta dëshmonin se ka pasur shkelje të dispozitave procedurale të LPK-së, sa i përket vendosjes meritore lidhur me refuzimin e kërkesëpadiës së tyre nga ana e Gjykatës së Apelit në Prishtinë *“Pretendimet e paditësve në revizion se kontrata për ndërrimin e paluajtshmërisë Leg.nr.378/61 e datës 25.04.1961 është lidhur pa pëlqimin e pronarit janë pa mbështetje në fakte relevante, sepse nuk ofrojnë ndonjë dokument me të cilin dëshmohet se ka ekzistuar rreziku serioz, ku i është cenuar jeta, trupi apo ndonjë e mirë tjetër e rëndësishme palës kontraktuese, në këtë rast trashëgimlënësit të paditësve, ashtu siç rregullohet me nenin 45, paragrafi 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077. Padia e paditësve për anulimin e kontratës Leg.nr.378/61 e datës 25.04.1961 është në kundërshtim me nenin 117 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978”*.
31. Më 12 shtator 2022, përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 74/22], Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesve të kërkesës, të paraqitur kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 3167/18] të 11 gushtit 2021 të Gjykatës së Apelit, duke theksuar se aktgjykimet e shkallëve më të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
32. Lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesës në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, Gjykata Supreme konsideroi se të njëjtat janë të pabazuara, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së. Gjykata Supreme vlerësoi se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna në aktgjykim, duke i dhënë harmoni logjike dhe juridike dispozitivit me arsyetimin.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me Aktgjykimin e kontestuar, u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tyre të garantuara me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe me nenin 1 të Protokollit 1 (Mbrojtja e Pronës) të KEDNJ-së.
34. Parashtruesit e kërkesës vlerësojnë se Gjykata Themelore gjykojti çështjen kontestuese në mënyrë të drejtë dhe në arsyetimin e aktgjykimit të saj paraqiti arsye të plota dhe të kuptueshme për të gjitha faktet që kanë qenë me rëndësi për të vlerësuar se kontrata kontestuese është absolutisht e pavlefshme, ndërsa Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, gjatë procedurës së zhvilluar, secila veç e veç kanë bërë shkeljen e të drejtave të parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
35. Tutje, parashtruesit e kërkesës theksojnë se *“Ndërlidhur me këto shkelje të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Gjykatës Supreme të Kosovës, paditësit theksojnë se gjykatat e cekura instanciale, paditësve u është shkelur e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm sikurse është përcaktuar me dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës, ku përfshihet*

edhe e drejta për të pasur një aktgjykim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore është një element qenësor i një vendimi të drejtë. Një kërkesë e tillë është përcaktuar edhe me dispozitat e nenit 160 al.4 dhe 5 e LPK-së. Funkzioni tjetër i një aktgjykimi gjyqësor i arsyetuar mirë dhe në pajtueshmëri me përmbajtjen e vërtetë të provave të shqyrtuara është që palëve ndërgjyqësore në procedurë t'iu dëshmohet që atë janë dëgjuar, si dhe atyre iu është ofruar mundësia për t'i shqyrtuar në mënyrë aktive dhe të barabartë të gjitha provat në pajtim me përmbajtjen e vërtetë të tyre. Arsyetimi kundërthënës dhe jo i drejtë i paraqitur në arsyetimin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Gjykatës Supreme të Kosovës e ka vënë në dyshim funksionin e një aktgjykimi gjyqësor të arsyetuar mirë, me arsyetim se gjykata e shkallës së parë-Gjykata Themelore në Prizren e ka vërtetuar faktin se paraardhësi i paditësve kontratën kontestuese për ndërrimin e paluajtshmerisë e ka lidhur nën ndikimin e kërcënimit me aplikimin e masave represive ndaj babait të paditësve duke ushtruar dhunë fizike, torturë dhe kërcënim ndaj familjes së babait të paditësve, se nëse nuk e lidh kontratën ai do të bojkotohet dhe do të cilësohej si tradhtar e popullit. Ky presion dhe ky kërcënim nuk mund të cilësohet si shkak për nulitet relativ të kontratës sikurse gabimisht e arsyetojnë në arsyetimin e aktgjyqimeve të tyre Gjykata e Apelit të Kosovës dhe Gjykata Supreme e Kosovës, me arsyetim se nga organet e pushtetit të atëhershëm në kohën e lidhjes së kontratës dhe kryetari i komunës është ushtruar presion psikik dhe fizik ndaj babait të paditësve, duke dërguar në milici dhe kërcënuar se nëse nuk e nënshkruan kontratën do të largohesh nga partia komuniste dhe do të trajtohesh si tradhtar i popullit”.

36. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se aktgjykimet e kontestuar të gjykatave të rregullta, me të cilat të njëjtëve iu është refuzuar kërkesëpadia si e pabazuar, nuk i kanë respektuar standardet kushtetuese të arsyetimit të vendimeve gjyqësore dhe kësaj janë përfshirë në shkelje të dispozitave nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Po ashtu, parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se e drejta e tyre për të kërkuar anulimin e kontratës për ndërrimin e paluajtshmerisë dhe kthimin e paluajtshmerisë është e garantuar edhe me dispozitat e nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së, “... me të cilin janë përcaktuar kufizime për çdo ndërhyrje në të drejta pronësore të ndonjë personi fizik apo juridik. Në vijim, parashtruesit e kërkesës iu referohen edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), duke theksuar se: “[GJEDNJ] me vendimet e saj ka përcaktuar shkallën e kufizimeve të së drejtës së pronësisë në paluajtshmeri dhe kushtet për ndonjë ndërhyrje ligjore në këto të drejta pronësore. Në praktikën e jurisprudencës së kësaj gjykate (psh. App1.2834/95 *Brumarecku vs. Rumania*, aktgjykimi i dt. 28. Tetor 1999) GJENDJ-ja ka përcaktuar se provimi se nëse ka ndonjë shkelje të së drejtës pronësore, duhet të vërtetohet faktikisht, realisht dhe në tërësinë e saj. E njëjta gjykatë përkujton se në kontestet gjyqësore lidhur me at se ka pasur marrje të paluajtshmerisë sipas rregullit të dytë nuk është e mjaftueshme të shqyrtohet se ka pasur vetëm marrje formale apo shpronësime të paluajtshmerisë, por duhet të shikohet dhe vërtetohet edhe rrethana reale faktike për të cilat është paraqitur kërkesa apo ankesa e qytetarit”.
37. Në fund, parashtruesit e kërkesës i propozojnë Gjykatës që në pajtim me dispozitat e paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit, rregullit 59 (1) të Rregullores së punës dhe pas përfundimit të seancës, të vendosë ashtu që:
- (I) të deklarojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës si të pranueshme,
 - (II) të konstatojë shkeljen e paragrafit 1 të nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për proces të rregullt gjyqësor) të KEDNJ-së, dhe

- (III) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [Rev. nr. 74/2022] e 12 shtatorit 2022 të Gjykatës Supreme, me të cilin është vërtetuar Aktgjykimin [Ac. nr. 3167/2018] i 11 gushtit 2021 i Gjykatës së Apelit, kurse Aktgjykimin [C. nr. 888/17] i 27 nëntorit 2017 i Gjykatës Themelore të mbetet në fuqi.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. *Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.*

NENI 1

Mbrojtja e pronës

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera”.

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

40. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

41. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës: janë palë të autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; e kontestojnë kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev. nr. 74/2022] e 12 shtatorit 2022 të Gjykatës Supreme; se i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113. 7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; se i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e kanë parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.

42. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e

pranueshmërisë], përkatësisht nënregullin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcakton:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.

43. Gjykata rikujton se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, si dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpall një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës (shih rastin [KI04/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
44. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës [KI166/20](#), parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GJEDNJ-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykimi i 24 nëntorit 1994, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).
45. Në këtë kontekst, si dhe në vazhdim të tekstit, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin [KI04/21](#), cituar më lart, paragrafi 28).

46. Rrethanat e rastit konkret, rezultojnë nga ajo se parashtruesit e kërkesës parashtruan padi kundër Komunës së Prizrenit, për shkak të anulimit të kontratës mbi ndërrimin e paluajtshmërisë, të cilën paraardhësi i tyre juridik i ndjerë, e ka lidhur me Komunën e Prizrenit dhe e njëjta është legalizuar nga Gjykata Komunale në Prizren më 25 prill 1961. Përmes kësaj padie, konstatuan se paluajtshmëritë e theksuara i janë marrë nga e paditura me qëllim të arondimit dhe zgjerimit të kompleksit i cili do të jetë pasuri e përgjithshme shoqërore. Po ashtu, theksuan se kontrata është lidhur kundër vullnetit të paraardhësit të tyre me kërcënimin se do ta dëbojnë nga puna dhe partia, pra nën kushtet e ekzistimit të presionit, kërcënimit dhe shantazhit, e të cilën e bënë absolutisht nule. Gjykata Themelore aprovoi padinë e parashtruesve të kërkesës, duke vendosur që kontrata e ndërrimit të paluajtshmërisë e lidhur ndërmjet paraardhësit të tyre dhe Komunës së Prizrenit është nule; obliguar e paditura Komuna e Prizrenit, që parashtruesve ligjorë si trashëgimtarë të të ndjerit Shyqri Beqaj t'ia dorëzojë në posedim dhe disponim të lirë pjesën e par. kat. nr. 7104 në sipërfaqe prej 18.52 ari; vërtetoi se padia është e tërhequr në pjesën me të cilën kërkohet dorëzimi në posedim të pjesës së par. kat. nr. 7104 në sipërfaqe prej 13,33h, e cila është e eksproprijuar për shkak të ndërtimit të shinave të hekurdhës Prizren - Fushë - Kosovë dhe pjesa e paluajtshmërisë së theksuar në sipërfaqe prej 0,02,23 h, në të cilën është ndërtuar rruga e asfaltuar për zonën industriale, sepse për këtë pjesë të sipërfaqes do të iniciohet procedurë e posaçme. Kundër vendimit të Gjykatës Themelore, parashtrroi ankesë Komuna e Prizrenit në Gjykatën e Apelit, ku kjo e fundit vendosi që ta aprovojë ankesën si të bazuar dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore kështu që refuzohet e pabazuar kërkesëpadija e parashtruesve të kërkesës. Të pakënaqur me vendimin e Gjykatës së Apelit, parashtruesit e kërkesës paraqitën revizion në Gjykatën Supreme, ku kjo e fundit e refuzoi revizionin e tyre si të pabazuar.
47. Gjykata vëren se esenca e pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, ndërlidhet me mosarsyetimin e vendimit gjyqësor nga ana e Gjykatës Supreme. Gjykata vlerëson se pretendimet e tilla ngrenë çështje nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNJ-së, të cilat Gjykata do t'i analizojë në pajtueshmëri me standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

(i) Sa i përket pretendimit për vendim të paarsyetuar gjyqësor

48. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës në kërkesën e tyre pranë Gjykatës, në esencë, theksojnë se kontrata e shitblerjes e lidhur në mes të paraardhësit të tyre dhe Komunës së Prizrenit është e pavlefshme, dhe duhet të shpallet nule, dhe se Gjykata Themelore ka vendosur drejtë, mirëpo Gjykata e Apelit dhe Supreme kanë vendosur në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës. Pra, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar se cilat kanë qenë faktet dhe provat të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit, pasi që “ ... nuk i kanë respektuar standardet kushtetuese të arsyetimit të aktgjykimeve të tyre dhe janë përfshirë në shkelje të dispozitave nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së”.
49. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka

një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së (përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet [Hadjianastassiou kundër Greqisë nr.12945/87](#), Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; [Van de Hurk kundër Holandës](#), Aktgjykim i 19 prillit 1994; [Hiro Balani kundër Spanjës nr. 18064/91](#), Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; [Higgins dhe të tjerët kundër Francës nr. 134/1996/753/952](#), Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; [Garcia Ruiz kundër Spanjës nr. 30544/96](#), Aktgjykimi i 21 janarit 1999; [Hirvisaari kundër Finlandës nr. 49684/99](#), Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; [Suominen kundër Finlandës nr. 37801/97](#), Aktgjykim i 1 korrikut 2003; dhe [Tatishvili kundër Ruisë nr. 1509/02](#), Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007.) Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në [KI22/16](#), parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; [KI143/16](#), parashtrues *Muharrem Blaku* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018; [KI87/18](#), parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019; si dhe rastin [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).

50. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih rastin e GjEDNj-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin [KI87/18](#), parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).
51. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GjEDNj-së [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), paragrafi 42; shih, po ashtu, rastin e Gjykatës [KI97/16](#), parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin [KI87/18 IF Skadeforsikring](#), të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin [Moreira Ferreira kundër Portugalisë nr.19867/12](#), Aktgjykim i 5 korrikut 2011 paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastin e Gjykatës [KI195/20](#), parashtrues *Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jo-bankar "Monego"*, Aktgjykim i 29 marsit 2021, paragrafi 122).
52. Gjykata me këtë rast rikujton se paraardhësi i parashtruesve të kërkesës kishte lidhur kontratë për ndërrimin e paluajtshmërive me Komunën e Prizrenit, dhe e cila ishte legalizuar përmes vendimit gjyqësor, gjë të cilën e kishin vërtetuar edhe Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.
53. Gjykata e Apelit, duke shpallur si të bazuar ankesën e Komunës së Prizrenit, kishte ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore [C. nr. 888/17] të 27 nëntorit 2017, duke e

refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës, ku ndër të tjera kishte theksuar si në vijim:

“Gjykata vlerëson se janë të pabazuara pretendimet e paditësit se në rastin konkret bëhet fjalë për nulitetin e kontratës nga neni 103 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, në bazë të të cilit nulitet në kuptim të nenit 110 të LMD-së, e drejta për të kërkuar anulimin e kontratës nuk shuhet, të cilin pretendim edhe e ka pranuar gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit të atakuar.. [...].

Gjykata e Apelit vlerëson se është e vërtetë se nga neni 109 i LMD-së del autorizimi ligjor, që gjykata kujdeset kryesisht për nulitetin e kontratës, mirëpo gjykata do të veprojë sipas këtij autorizimi vetëm në rastet kur gjen se kontrata është lidhur në kundërshtim me dispozitën e nenit 103 të LMD-së, respektivisht kur kontrata është në kundërshtim me Kushtetutën, rregullin 4 shoqëror, dispozitat e detyrueshme apo moralin shoqëror, në rastin konkret gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë se kontrata është lidhur në kundërshtim me dispozitën e nenit 103 të LMD-së. Gjykata e Apelit nuk ka gjetur asnjë fakt sipas të cilit kontrata lëndore do të kualifikohej në rrethanat që e bëjnë të njëjtën absolutisht nule, ndërsa nëse kërkesa e padisë referohet vetëm në të meta e vullnetit të kontratës, atëherë çështja do të duhej të trajtohej në kuadër të dispozitave ligjore për kontratat e rrëzueshme, e që në këtë rast sipas dispozitës së nenit 111 të LMD-së, sipas së cilës përcaktohet se: "Kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidhur pala me zotësi të kufizuar për të vepruar, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është caktuar me këtë ligj ose me dispozitë të veçantë", por që e drejta për të kërkuar rrëzimin e kontratës sipas kësaj dispozite ndërlidhet me kufizimin që përcakton dispozita e nenit 117 al.1 dhe 2 të LMD-së, me të cilën përcaktohet se, e drejta për të kërkuar anulimin e rrëzueshmërisë së kontratës pushon me skadimin e afatit prej 1 viti, e në çdo rast pas skadimit të afatit prej 3 vitesh, në këtë rast edhe nga e paditura si në përgjigje në padi ashtu edhe në seancë për shqyrtim kryesor është dhënë prapësimi i kalimit të afatit për anulimin e kontratës sipas rrethanave që kontratën e bëjnë të rrëzueshme”.

54. Gjykata Supreme në Aktgjykimin [Rev. nr. 74/22] të 26 shtatorit 2022 vlerësoi se pretendimet e parashtruesve të kërkesës në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë në shkëlqje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, Gjykata Supreme konsideroi se të njëjtat janë të pabazuara, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së. Gjykata Supreme vlerësoi se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata Supreme pranoi qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë si të rregullt dhe të ligjshëm, duke theksuar se: *“... e drejta e pronësisë është e drejtë subjektive e karakterit absolut dhe se sendet e paluajtshme të cilat janë të regjistruara në librat kadastral, ulen supozimi se sendi është në pronësi të personit në emër të të cilit është e regjistruar, mirëpo edhe nëse paluajtshmëria nuk është e regjistruar në emër të atij, që kërkon pronësinë, në këtë rast pala paditëse ka pasur detyrim ta provoj pronësinë e vet, por edhe të paraardhësit të tyre, derisa mos të gjendet personi i cili pronësinë e ka fituar në ndonjërin prej mënyrave origjinale si mënyra të fitimit të pronësisë, dhe këto fakte në këtë rast, i ka vërtetuar pala e paditur e jo pala paditëse. Paditësit në këtë rast nuk kanë arritur t'i vërtetojnë faktet mbi të cilat e mbështesin kërkesën e tyre edhe pse kjo ka qenë detyrë e tyre”.* Lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesës se kontrata është lidhur nën ndikimin e dhunës dhe kërcënimit, Gjykata Supreme konsideroi se *“në këtë rast pala paditëse ka humbur të drejtën të kërkojë anulimin e kontratës mbi këtë bazë, për arsye se*

ka lëshuar afatin ligjor në kuptim të nenit 111 e lidhur me nenin 117 të LMD-së, për shkak se afati i paraparë ligjor për anulimin e kontratës mbi këtë bazë është afat prekluziv-ligjor, prej një viti, i cili nuk mund të shtyhet i cili llogaritet nga dita e kur të jetë ditur shkak i rrezikshmërisë-respektivisht i pushimit të dhunës – afati subjektiv dhe 5 viteve nga dita e dhënies së deklaratës-afati objektiv”. Ndërsa, lidhur me pretendimet e parashtruesve të kërkesës se në këtë rast kemi të bëjmë me nulitet absolut, Gjykata Supreme vlerësoi se të njëjtat nuk qëndrojnë: “është i vërtetë fakti se me nenin 109 të LMD-së, del autorizimi ligjor, që gjykata kujdeset kryesisht për nulitetin e kontratës, mirëpo gjykata do të veprojë sipas këtij autorizimi vetëm në rastet kur gjen se kontrata është lidhur në kundërshtim me dispozitën e nenit 103 të LMD-së, respektivisht kur kontrata është në kundërshtim me Kushtetutën, rregullin shoqëror, dispozitat e detyrueshme apo moralin shoqëror. Në këtë rast, Gjykata nuk ka konstatuar ndonjë rrethanë se kontrata lëndore është lidhur në kundërshtim me nenin 103 të LMD-së”.

55. Gjykata vëren se fillimisht Gjykata e Apelit e më pas edhe Gjykata Supreme, kishin konstatuar se edhe sikur kontrata të ishte lidhur në ndikimin e dhunës, kërcënimit etj, parashtruesit prapë e kanë humbur të drejtën të kërkojnë anulimin e kontratës mbi këtë bazë, për arsye se e kanë lëshuar afatin ligjor në kuptim të nenit 111 lidhur me nenin 117 të LMD-së, për shkak se afati ligjor mbi këtë bazë është afat prekluziv – ligjor, prej një viti, i cili nuk mund të shtyhet dhe llogaritet nga dita kur të jetë i ditur shkak i rrëzueshmërisë – respektivisht pushimit të dhunës afati subjektiv, ndërsa 5 vite nga dita e dhënies së deklaratës afati objektiv. Pra, kontrata mbi ndërrimin e paluajtshmërisë ishte legalizuar pranë Gjykatës Komunale në Prizren përmes vendimit [Leg. nr. 378/61] të 25 prillit 1961, ndërsa padia e parashtruesve të kërkesës për anulimin e kësaj kontrate ishte dorëzuar në Gjykatë më 16 korrik 1998, pas 37 vitesh.
56. Gjykata me këtë rast, rikujton se nisur nga praktika e GjEDNj-së dhe e Gjykatës, e njëjta nuk kërkon përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesit e kërkesës. Megjithatë, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar.
57. Në këtë kontekst, Gjykata, duke u bazuar në sqarimet si më sipër, dhe në mënyrë specifike duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesit e kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ata, dhe gjithashtu arsyetimet e gjykatave të rregullta e të shtjelluara më lart, konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme nuk karakterizohet me mungesë të vendimit të arsyetuar gjyqësor. Për pasojë, pretendimi i parashtruesve të kërkesës përkitazi me mungesën e vendimit të arsyetuar gjyqësor është qartazi i pabazuar në bazë kushtetuese në “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes” ashtu siç përcaktohet me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

Përkitazi me pretendimet tjera

58. Siç u cek më lart, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, shkel të drejtat e tyre të garantuara me nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNj-së. Mirëpo, parashtruesit e kërkesës vetëm e përmendin nenin përkatës, por nuk shtjellojnë më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtij neni përkatës të KEDNj-së. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesave duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente

bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese [KI187/18](#) dhe [KI11/19](#), parashtrues: *Muhamet Idrizi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2019, paragrafi 73; [KI125/19](#) parashtrues: *Ismajl Bajgora*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 63; dhe së fundmi rastin [KI175/20](#), parashtrues *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 26 marsit 2021, paragrafët 79-82).

59. Thënë këtë, Gjykata konsideron se pretendimin për shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së, parashtruesit e kërkesës, në të vërtetë, i kanë elaboruar mbi bazën e nenit 31 të Kushtetutës, duke e ndërlidhur shkeljen e këtyre të drejtave themelore, me mosarsyetimin e vendimeve gjyqësore, për çfarë Gjykata sa mësipër konstatoi se në këtë pjesë kërkesa duhet të shpallet qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht e papranueshme, për arsyt e lartcekura.
60. Prandaj, Gjykata konstaton se përkitazi me këto pretendime të parashtruesve të kërkesës, Gjykata konkludon që kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë së (iii) pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi nenet e Kushtetutës, pa shpjeguar se si janë shkelur ato. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Përfundim

61. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me mosarsyetimin e vendimit gjyqësor, që bien në fushëveprimin e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të KEDNj-së, i përkasin kategorisë së dytë (ii) të pretendimeve “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, andaj të njëjtat duhet të deklarohen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.
62. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së, duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë së (iii) pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”.
63. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, duhet të deklarohet e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 17 korrik 2024, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese




Gresa Caka-Nimani